



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 93, Datë 02.04.2026

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “PROSOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 705/5 prot., datë 01.04.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “PROSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609 prot., datë 10.10.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 259, datë 21.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë në lidhje me plotësimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit, bordi i ERE-s me vendimin nr. 339, datë 23.12.2025, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së kërkesës së shoqërisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kushtin që shoqëria brenda datës 13.01.2026, të depozitojë në ERE përgjigjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për kërkesën e bërë nga ana e saj në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaik, si dhe raportimet periodike të depozituara në MIE, në kuadër të zhvillimit të projektit. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 2609/15 prot., datë 29.12.2025.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 16, datë 26.01.2026, vendosi të pezullojë procedurën e licencimit të shoqërisë “PROSOL” sh.p.k., deri në depozitim nga shoqëria të

përgjigjes/qëndrimit të MIE-s për kërkesën e bërë nga ana e saj në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaiik.

- Ky vendim dhe kushtet respektive ju njoftuan shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 142/2 prot., datë 02.02.2026.
- Në vijim, MIE me shkresën nr. 1724 prot., datë 18.02.2026, ka sqaruar se sipas Kontratës nr. 1353 rep., nr. 578 kol., datë 18.03.2025, kapaciteti i instaluar i centralit është 21 MW, ndërsa kapaciteti në pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit është element kontraktor ndërmjet gjeneruesit dhe OST.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 705/1 prot., datë 25.02.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për zhvillimin e një seance dëgjimore, me qëllim sqarimin e mëtejshëm të kapacitetit, dhe rishikimin e dokumenteve të aplikimit.
- Me shkresën nr. 705/2 prot., datë 06.03.2026, ERE i është drejtuar shoqërisë “PROSOL” sh.p.k., me ftesën për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, e cila u zhvillua më datë 17.03.2026, në ambientet e ERE-s.
- Në këtë seancë, shoqëria është shprehur se do të rifreskojë dokumentacionin për ta përputhur me kapacitetin e miratuar nga MIE, duke ridepozituar Shtojcën nr. 2, planin e biznesit, VNM paraprake të korrigjuar ose të re, si dhe do t'i drejtohet OST sh.a., me kërkesën për miratimin e kapacitetit 21 MW, dhe lëshimin e një dokumenti në kuadër të këtij kapaciteti.
- Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 705/4 prot., datë 18.03.2026, shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike, me qëllim depozitimin e dokumentacionit të sipërcituar.

### **Heqja e pezullimit dhe zgjatja e vendimmarrjes**

- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se një pjesë e dokumentacionit mund të përgatitet nga vetë shoqëria, ndërsa për pjesën tjetër ajo duhet të dokumentojë në ERE aplikimet apo kërkesat përkatëse për lëshimin e dokumenteve sipas kapacitetit të miratuar nga MIE, vlerësohet që të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrja e bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë për licencim. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 2 të rishikuar, planin e biznesit të përditësuar, si dhe aplikimet/kërkesat përkatëse pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe OST sh.a. apo miratimet/qëndrimet e këtyre organeve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e bordit nr. 16, datë 26.01.2026, *“Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”*.
2. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
3. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin e përditësuar të aplikimit.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “PROSOL” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrît AHMETI**